




Planuar / Doretuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	14.09.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënjë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHICK	5396	2022	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.710/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.710/2022 të datës 16.08.2022 të parashtruar nga ankesuesja _____ nga _____ me adresë _____

kundër Vendimit me numër protokolli 301 të datës 18.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. *Refuzohet si e pa bazuar* ankesa me numër A.nr.710/2022 të datës 16.08.2022, e parashtruar nga ankesuesja _____

II. *Mbetet në fuqi* Vendimi me numër protokolli 301 i datës 18.07.2022 i Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, më datë 16.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4757/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 301 të datës 18.07.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 23.08.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4757/2022 të datës 16.08.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 301 të datës 18.07.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Emailin e datës 21.07.2022 për ankuesen; Vendimin me numër protokoll 631 të datës 30.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Akt Emërimit me numër protokoll 17 të datës 28.12.2017 për ankuesen; Kërkesën për avancim e datës 11.10.2017; Diplomën me Nr.003/15 të ankueses; Pasqyrën e trajnimit të personelit; Certifikatën nëntor 2021, tetor 2014; Emailin e datës 22.03.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 23.08.2022; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit me numër protokoll 292 i datës 24.04.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankueses i datës 27.01.2021 dhe Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të ankueses të datës 31.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur së ankuesja në bazë të Akt Emërimit me numër protokoll 17 të datës 28.12.2017, është emëruar në pozitën *Nëpunëse për Informim* në Zyrën e Punësimit në Fushë Kosovës. Me Vendimin me numër protokoll 631 të datës 30.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (me tej APRK), ankuesja është ngarkuar me detyrat dhe përgjegjësitë e pozitës Zyrtar për Shërbime të Punësimit në Zyrën e Punësimit në Fushë Kosovë, duke u shkarkuar nga detyrat e përgjegjësitë e pozitës Zyrtar për Informim në Zyrën e Punësimit në Fushë Kosovë. Ndërsa më Vendimin me numër protokoll 301 të datës 18.07.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës ka shfuqizuar Vendimi me numër protokoll 631 të datës 30.12.2021, duke vendosur që ankuesja të kthehet në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2017.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokoll 301 të datës 18.07.2022, pretendon se emërimi në pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësi është bërë për shkak të nevojave të shumta të numrit të punëkërkuësve, sepse ka qenë e pamundur për të shtuar staf i ri, kështu që ky vendim është në kundërshtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë Vendimin me numër protokoll 631 të datës 30.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm



të APRK-së Kosovës dhe si rrjedhojë ka gjetur se me vendimin në fjalë ankuesja nga pozita e Zyrtarit për Informim ishte ngarkuar me detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Shërbim, mbi bazën e mungesës së stafit në ofrimin e shërbimeve të punësimit punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe pamundësisë së shtimit të stafit të ri, ndërsa si referencë ligjore e nxjerrjes së vendimit ka qenë neni 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura sipas të cilit nen thuhet se: *"Drejtori ekzekutiv drejton dhe përfaqëson Agjencinë dhe në mënyrë të veçantë është përgjegjës për:....*
1.2. menaxhimin e burimeve njerëzore të Agjencisë në pajtim me ligjin për zyrtarët publikë.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton së Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrës së Vendimit me numër protokolli 631 të datës 30.12.2021 ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 23 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit Nr.06/L-113 për Organizmin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: *"1. Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë..."*, sepse sipas Kolegjit një pozitë e lirë në shërbimin civil mund të plotësohet fillimisht përmes procedurës së përcaktuar në nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku në mënyrë shprehimore thuhet se: *"Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë..."*. Ndërlidhur me këtë, kur vlerësohet e nevojshme dhe në interes të institucionit mund të zbatohen edhe dispozitat e transferimit të përkohshëm të nenit 52 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *"Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve"*, andaj, meqenëse bartja e detyrave edhe përgjegjësive të ankuses nga pozita e punës së Zyrtarit për Informim në pozitën e punës Zyrtar për Shërbim, është bërë pa zbatim të procedurave të theksuara si me sipër, Kolegji konstaton së Vendimi me numër protokolli 631 i datës 30.12.202 është i përfshirë me shkelje procedurale dhe si tillë konsiderohet akt administrativ i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson së Zëvendësuesi i Drejtorit të i Përgjithshëm i APRK-së me rastin e nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me ankesë, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.48/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

